

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

ITX Albania Sh.p.k. ("Shoqëria") u krijua si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 27 nëntor 2013. Vendndodhja kryesore e aktivitetit është në Tiranë, Shqipëri. Shoqëria zotërohet 100% nga Zara Holding BV ("shoqëria mëmë"). Pronari përfundimtar përfitues është Amancio Ortega Gaona. Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 100 aksione me vlerë 4,000,000 LEK secili. Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë më 31 dhjetor 2022 është Ana Rogic.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është shitja e produkteve të modës dhe shtepiake nëpërmjet dyqaneve me pakicë dhe shitjeve online. Shoqëria aktualisht po menaxhon tetë dyqane të gjashtë markave të ndryshme: Zara, Zara Home, Bershka, Stradivarius, Pull & Bear dhe Massimo Dutti. Gjashtë prej tyre ndodhen në qendrën tregtare Tirana East Gate ("TEG") në Lundër, Tiranë, Shqipëri. Pesë dyqane janë hapur që nga data 16 prill 2014. Tre dyqane të reja janë hapur në shtator 2018: Zara Home në Tirana East Gate ("TEG") dhe Bershka dhe Stradivarius në Qendrën Tregtare Univers ("QTU"). Më 13 shkurt 2020, Shoqëria prezantoi për herë të parë blerjet online për dyqanin Zara. Në 13 Tetor 2021 Shoqëria gjithashtu mundësoi blerjet online për dyqanin Massimo Dutti.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Rruga "Dervish Hima", Ndërtesa "Ambassador 3".

Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria kishte 329 punonjës (31 dhjetor 2021: 259 punonjës).

Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 17 datë 16.01.2019, në zbatim të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, një Njësi ekonomike mund të klasifikohet si i rëndësishëm për Interesin Publik (NJIP) për shkak të natyrës së biznesit, madhësinë ose numrin e punonjësve të tyre. Shoqëria klasifikohet si NJIP për shkak të numrit të të punësuarve dhe vlerës së aktiveve, të ardhurave.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK)

a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

b) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë aktivitetet e saj dhe të përmbushë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit. Shoqëria bazohet në këtë supozim duke marrë parasysh pozicionin financiar të shoqërisë mëmë, objektivat aktuale, rentabilitetin e operacioneve dhe aksesin në burimet financiare.

Në këtë mjedis, infrastruktura teknologjike dhe iniciativat e digjitalizimit, si bazë e strategjisë së integruar të Shoqërisë, kanë bërë të mundur vazhdimin e veprimtarisë me një farë mase normaliteti dhe efikasiteti, duke garantuar shitjet online, menaxhimin efikas të inventarit të integruar dhe adresimin e kërkesave kryesore në mënyrë të sigurt.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore kontabël janë përcaktuar më poshtë.

a. Transaksionet në monedhë të huaj

Fitimi ose humbja nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj është diferenca që rezulton nga një numër i dhënë njësisht të një monedhe të huaj në Lekë me kurse këmbimi të ndryshëm. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetarë të shprehura në monedhë të huaj konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerën e drejtë ri-konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit zyrtarë për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit kontabël të cilat shprehen në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë (Leku ndaj kurseve të huaja të këmbimit):

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
1 EUR	114.23	120.76
1 USD	107.05	106.54

b. Aktivitet Afatgjata Materiale*(i) Njohja dhe vlerësimi*

Aktivitet Afatgjata Materiale janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar, nëse ka. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktiveve. Kostot për ndërtimin vetë të një aktivi përfshijnë kostot për materialet dhe mjetet e përdorura në ndërtimin e aktivitet, kostot e punës (pagat, tatimet dhe kontributet përkatëse paguar punonjësve në lidhje me ndërtimin e aktivitet) dhe çdo kosto e drejtpërdrejtë e nevojshme për ta sjellë aktivin në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit i një zëri të aktiveve afatgjata përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël të aktivitet dhe njihen neto në të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave.

Në fund të çdo periudhe raportuese, drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të AAM. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si më e larta midis vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin, në masën që tejkalon tepicën e mëparshme të rivlerësimit në kapital. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme anulohet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim të aktivitet ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

(ii) Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme dhe kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivitet i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato marrin pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike për Shoqërinë. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen në pasqyrën e humbje/fitimit kur ato ndodhin.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**b. Aktive Afatgjata Materiale (vazhdim)***(iii) Amortizimi*

Vlera e amortizueshme e një zëri të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përdorur metodën lineare për të gjitha aktivet materiale mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë që prej ditës së parë të muajit pasues të muajit të blerjes.

Normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria janë si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e amortizimit	Jeta e dobishme
Mobilje dhe Pajisje	Metoda lineare	12
Pajisje Elektronike	Metoda lineare	5
Te tjera aktive fikse	Metoda lineare	3
Përmirësimet e objekteve me qira	Metoda lineare	12

Vlera e mbetur, jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit, rishikohen dhe rregullohen kur është e përshtatshme, në çdo vit financiar. Ndryshimet në metodën e amortizimit do njihen si ndryshime në vlerësime kontabël.

c. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale, zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme të aktivitetit, nëse kjo shumë është më e ulët se vlera e tij kontabël. Për të përcaktuar nëse një aktiv mund të ketë rënë në vlerë, kryhet një test, nëpërmjet të cilit vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Një test zhvlerësimi kryhet në çdo datë të bilancit për aktivet që tregojnë shenja të rënies në vlerë. Testi i zhvlerësimit kryhet me qëllim që të përcaktohet shuma e rikuperueshme e një aktivi afatgjatë, e cila është shuma më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi afatgjatë (minus koston e shitjes) dhe vlerës në përdorim të tij. Vlera kontabël neto e aktivitetit reduktohet nëse si vlera e tij e drejtë (minus koston e shitjes) ashtu edhe vlera në përdorim janë më të ulëta se vlera e tij kontabël.

Nëse ka indikacione se shuma e rikuperueshme e AAM është rritur më shumë se vlera e tij kontabël, humbja e mëparshme nga zhvlerësimi rimerret dhe vlera kontabël e aktivitetit rritet. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm në atë masë që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga zhvlerësimi ose amortizimi, nëse nuk ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Rimarrja e humbjes nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave të periudhës aktuale si një zvogëlim i humbjes nga zhvlerësimi.

d. Çregjistrimi

Një aktiv afatgjatë material çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo kur nuk priten më përfitime ekonomike nga përdorimi apo nxjerrja jashtë përdorimit e tij. Çdo fitim ose humbje që vjen nga çregjistrimi i aktivitetit (përcaktuar si diferencë mes arkëtimit të shitjes dhe vlerës së mbetur të aktivitetit) njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktiviteti çregjistrohet.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**e. Inventarët**

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përcaktohet duke përdorur metodën “hyrje e parë, dalje e parë” (FIFO).. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme i referohet çmimit të shitjes që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit, minus të gjitha kostot e vlerësuara për kryerjen e transaksionit.

Për më tepër, përcaktimi i vlerës neto të realizueshme ndikohet nga ecuria e variablave të ndryshëm tregtarë, të lidhur kryesisht me suksesin e arkëtimit, i cili përcakton performancën e shitjeve, rotacionin e stokut, vëllimin e njërive të skontuara dhe përqindjen e skontimit.

Në çdo datë raportimi, Shoqëria llogarit provizionin që korrespondon me inventarët që vlerësohet të shiten nën çmimin e tyre të blerjes. Ky provizion bëhet për çdo fushatë dhe për çdo koncept të shitjes me pakicë. Çmimi i shitjes së mallrave ndryshon gjatë jetës së tyre tregtare dhe gjatë sezonit të shitjes një pjesë e koleksioneve të ndryshme shitet me zbritje.

f. Instrumentet financiarë

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali të një njësie tjetër.

Aktivitet financiarë*(i) Njohja dhe matja fillestare*

Aktivitet financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, siç maten më pas me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) dhe vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH). Shoqëria mat fillimisht një aktiv financiar me vlerën e tij të drejtë plus, në rastin e një aktivi financiar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit. Të arkëtueshmet tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka zbatuar përjashtimin praktik maten me çmimin e transaksionit të përcaktuar sipas SNRF 15. Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet ATGJ, ai duhet të krijojë flukse monetare që janë "vetëm pagesa të principalit dhe interesit – (VPPI)" mbi shumën e papaguar të principalit. Ky vlerësim quhet testi VPPI dhe kryhet në nivel instrumenti. Shoqëria nuk ka mbajtur asnjë aset financiar VPPI për periudhën raportuese.

Modeli i biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si menaxhohen këto aktive për të gjeneruar flukse monetare. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset monetare do të rezultojnë nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, shitja e aktiveve financiare ose nga të dyja. Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare bazohet në mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale.

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivitet financiarë klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumentet e borxhit)
- Aktive financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet ATGJ me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit)
- Aktive financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet ATGJ pa riciklim të fitimeve dhe humbjeve kumulative pas çregjistrimit (instrumentet e kapitalit neto)
- Aktive financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes

Aktivitet financiarë me kosto të amortizuar (instrumentet e borxhit)

Aktivitet financiarë me kosto të amortizuar maten më pas duke përdorur metodën e interesit efektiv (IE) dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitime ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivitet financiarë të Shoqërisë me kosto të amortizuar përfshijnë të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

e. Instrumentet financiarë (vazhdim)

(iii) Fshirja

Aktivet financiare fshihen, tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka shteruar të gjitha përpjekjet praktike për rikuperim dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme rikuperimi. Shlyerja përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë ende subjekt i veprimtarisë përmbarrimore kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të detyrimeve kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperim.

(iv) Çregjistrimi

Një aktiv financiar çregjistrohet kur Shoqëria humbet të drejtën mbi flukset e parave të aktivit financiar ose transferon të drejtën për të marrë flukset e parave që vijnë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilën transferohen gjithashtu edhe të drejtat dhe rreziqet e pronësisë së aktivit financiar.

Shoqëria hyn në transaksione ku ajo transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por ruan ose të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në këto raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, hua, të pagueshme, ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt këtij transaksioni.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera të pagueshme.

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç shpjegohet më poshtë:

- Detyrime financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes
- Detyrimet financiare me kosto të amortizuar (kreditë dhe huamarrjet)

Shoqëria nuk ka të klasifikuar ndonjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

(iii) Çregjistrimi

Një detyrim financiar çregjistrohet kur ky i fundit shlyhet, anulohet apo skadon.

Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjërisht për të kompensuar shumat e njohura, dhe ka një qëllim që ose të shlyhet në bazë neto, ose të realizohet aktivi dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Një e drejtë e tillë kompensimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagimi dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL(VAZHDIM)

g. Provigjionet

Provigjioni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

h. Të ardhurat nga kontratat me klientët

Të ardhurat e Shoqërisë gjenerohen kryesisht nga shitja e veshjeve, aksesorëve, këpucëve, kozmetikës, tekstileve shtëpiake dhe pajisjeve shtëpiake për konsumatorët. Klientët janë kryesisht individë privatë, ku çmime të njëjta aplikohen për të gjithë klientët. Çdo ulje çmimi është e përgjithshme dhe nuk i drejtohet ndonjë individi specifik.

Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli i mallrave i transferohet klientit në një shumë që pasqyron vlerën për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të këtyre mallrave. Të ardhurat nga shitjet raportohen si shitje neto në pasqyrën e të ardhurave, pra të ardhurat nga shitjet minus tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet dhe zbritjet.

Shoqëria në përgjithësi ka arritur në përfundimin se po vepron si shitës kryesor në marrëveshjet e saj të të ardhurave, duke pasur kontrollin e plotë mbi mallrat përpara se t'i transferojë ato te klienti.

Të ardhurat si nga shitjet në dyqane ashtu edhe nga ato online raportohen në lidhje me shitjet te klientët. Në rastin e shitjeve në dyqan, çmimi i transaksionit duhet të paguhet menjëherë kur klienti bën blerjen dhe merr produktin në dyqan. Në rastin e shitjeve online, të ardhurat raportohen kur kontrolli i mallrave konsiderohet i transferuar dhe kur porositë dërgohen nga magazina.

Shoqëria shqyrton nëse ka angazhime të tjera në kontratë që janë detyrime të veçanta të performancës, të cilave duhet t'u alokohet një pjesë e çmimit të transaksionit (p.sh., garancitë, pikët e besnikërisë së klientit). Në përcaktimin e çmimit të transaksionit për shitjen e mallrave, Shoqëria merr në konsideratë efektet e shumës së ndryshueshme, ekzistencën e komponentëve të rëndësishëm financues, konsideratën jo-monetare dhe shumën që i paguhet klientit (nëse ka).

Pagesat e ndryshueshme

Nëse vlera në një kontratë përfshin një shumë të ndryshueshme, Shoqëria vlerëson shumën e pagesës për të cilën do të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave te klienti. Vlera e ndryshueshme vlerësohet në fillimin e kontratës dhe kufizohet derisa të jetë shumë e mundshme që një rikthim i rëndësishëm i të ardhurave në shumën e të ardhurave kumulative të njohura nuk do të ndodhë kur pasiguria e lidhur me shumën e ndryshueshme të zgjidhet më pas.

Shoqëria u ofron klientëve të drejtën për t'i kthyer mallrat brenda një periudhe të caktuar, e cila shkakton një pagesë të ndryshueshme.

Të drejtat e kthimit

Bazuar në të dhënat historike dhe vlerësimet më të mira, njësia ekonomike përcakton pagesat e ndryshueshme. Shoqëria më pas zbaton kërkesat për vlerësimet kufizuese të shumës së ndryshueshme në mënyrë që të përcaktojë shumën e konsideratës së ndryshueshme që mund të përfshihet në çmimin e transaksionit dhe të njihet si e ardhur. Një detyrim rimbursimi njihet për mallrat që pritet të kthehen (d.m.th., shuma që nuk përfshihet në çmimin e transaksionit). E drejta e kthimit të aktivitetit (dhe rregullimi përkatës i kostos së shitjes) njihet gjithashtu për të drejtën për të rikuperuar mallrat nga klienti.

Asnjë element financimi nuk konsiderohet i pranishëm pasi shitjet bëhen me një afat kredie maksimale nga 0-30 ditë, gjë që është në përputhje me praktikën e tregut. Një llogari e arkëtueshme njihet kur mallrat dorëzohen pasi ky është momenti kohor kur shuma është e pakushtëzuar sepse kërkohet vetëm kalimi i kohës përpara se të bëhet pagesa.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

h. Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)

Aktivitet kontraktuale:

Një aktiv kontraktual është e drejta për të marrë në këmbim të mallrave ose shërbimeve të transferuara te klienti. Nëse Shoqëria transferon shërbime te një klient përpara se klienti të paguajë shumën ose përpara se të bëhet pagesa, një aktiv kontraktual njihet për shumën e fituar që është i kushtëzuar.

Detyrimet kontraktuale:

Një detyrim kontraktual është detyrimi për të transferuar mallra ose shërbime te një klient për të cilin Shoqëria ka marrë shumën (ose një pjesë të shumës) nga klienti. Kur klientët paguajnë shumën para se Shoqëria të transferojë mallrat ose shërbimet te klienti, do të njihen detyrime kontraktuale në formën e parapagimeve. Detyrimet kontraktuale njihen si të ardhura në momentin e dorëzimit të mallrave.

Detyrimet kontraktuale janë shumë operationale në natyrë dhe nuk kanë një komponent të rëndësishëm financiar.

i. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë e marra, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar nëpërmjet fitimit ose humbjes (nëse ka), dhe humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

j. Shpenzimet aktuale dhe të shtyra të tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në pasqyrën e performancës financiare, përveç rasteve kur lidhen me zërat e njohur drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm ose arkëtueshëm mbi fitimin/(humbjen) e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdo lloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke identifikuar diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar si dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në normat tatimore që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi brenda datës së raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet nëse është e mundur që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoret diferenca e përkohshme. Aktivitet tatimor të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor përkatës do të realizohet. Një detyrim tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme.

Në periudhën raportuese, Shoqëria ka identifikuar diferenca në normat e amortizimit dhe metodat e aplikuar për qëllime kontabël dhe ato të përcaktuara nga legjislacioni tatimor. Për pasojë, Shoqëria ka llogaritur efektin në tatimet e shtyra.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**k. Qeratë**

Shoqëria ka marrë me qira një dyqan (ambientet e Zara Home), zyrën e administratës dhe tre magazina. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-qirasë. Shoqëria shpërndan shumën në kontratë për komponentët e qirasë dhe jo-qirasë bazuar në çmimet e tyre relative të pavarura. Megjithatë, për qiratë e automjeteve për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, ajo ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit e qirasë dhe jo-qirasë dhe në vend të kësaj i llogaritë këto si një komponent i vetëm qiraje. Komponenti jo-qira i kontratave të automjeteve përbëhet nga kostoja e shërbimeve të rregullta mujore të përfshira në kështet mujore të kontraktuara. Shoqëria njeh aktivet me të drejtën e përdorimit në datën e fillimit të qirasë (d.m.th., në datën kur aktivi bazë është i disponueshëm për përdorim).

Aktivitet me të drejtën e përdorimit maten me kosto, minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo ri matje të detyrimeve të qirasë.

Kostoja e aktiveve me të drejtën e përdorimit përfshin:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë qiraje e bërë në ose përpara datës së fillimit minus çdo stimul qiraje të marrë,
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot e nevojshme për të rikthyer aktivin në kushtet e kërkuara nga marrëveshja e qirasë.

Aktivitet me të drejtë përdorimit përgjithësisht amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër ndërmjet jetës së dobishme të aktivitetit dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Shoqëria është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të ushtrojë një opsion blerjeje, aktivi me të drejtë të përdorimit amortizohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve bazë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë të përdorimit të lidhura me dyqanet dhe zyrat qendrore llogaritet duke përdorur metodën lineare për një afat të caktuar qiraje.

Jeta e dobishme në vite (në fillimin e qirasë)

Dyqanet	15
Magazinat	10-16
Zyra e administrimit	10

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesat fikse (duke përfshirë pagesat fikse në thelb), minus çdo stimul qiraje të arkëtueshme,
- pagesa e ndryshueshme e qirasë që bazohet në një indeks ose një normë, të matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit të kontratës,
- shumat që pritet të paguhet nga Shoqëria nën garancitë e vlerës së mbetur,
- çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Shoqëria është e sigurt në mënyrë të arsyeshme se do ta ushtrojë atë opsion, dhe
- pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse shoqëria e ushtron këtë opsion.

Pagesat e qirasë aktualizohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, përdoret norma e huamarrjes shtesë së Shoqërisë.

Inditex ka përcaktuar një model për të përcaktuar normën e interesit për huamarrje shtesë bazuar në normën pa risk të një obligacioni shtetëror ekuivalent me kohëzgjatjen e afatit të qirasë dhe primin e riskut të korporatës. Ky model konsideron se shpërndarja e pagesave kontraktuale të një obligacioni shtetëror pa risk ndryshon nga shpërndarja e pagesave të qirasë gjatë afatit të qirasë. Formula është përdorur për të përcaktuar kohëzgjatjen e obligacionit pa risk ekuivalent me afatin trevjeçar të qirasë. Norma e interesit e përdorur për llogaritjen e detyrimit të qirasë është 5,31% për ambientet e Zara Home dhe 2,31% për ambientet e zyrave të administratës.

Pas datës së fillimit, shuma e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar rritjen e interesit dhe zvogëlohet për pagesat e qirasë të bëra.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

k. Qeratë (vazhdim)

Përveç kësaj, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshime në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar këtë pagesat e qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë aktivin e qirasë.

Pagesat e qirasë shpërndahen ndërmjet pagesave të principalit dhe kostove financiare. Kostot financiare ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë periodike konstante interesi për tepricën e mbetur të detyrimit për çdo periudhë.

Shoqëria ka pagesa të ndryshueshme të qirasë që janë të lidhura me performancën ose përdorimin e ardhshëm të një aktivi të qirasë, prandaj këto kontrata përjashtohen nga përkufizimi i pagesave të qirasë. Shoqëria nuk ka njohur asnjë detyrim apo të drejtë përdorimi të aktiveve. Shumica e dyqaneve të ITX Albania kanë pagesa të ndryshueshme qiraje në varësi të një përqindje të caktuar mbi shitjet neto (d.m.th. komisionet). Shoqëria ka pesë kontrata qiraje që përfshihen në objektin e SNRF 16: ambientet e Zara Home, tre magazina dhe ambientet e zyrës së administratës.

l. Transaksionet me palët e lidhura.

Palët e lidhura të Shoqërisë përbëhen nga Shoqëria e saj mëmë Zara Holding BV së bashku me subjekte të tjera që kontrollojnë ose kontrollohen nga kjo fundit. Në shqyrtimin e çdo marrëdhënieje të mundshme të palës së lidhur, vëmendja i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

m. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit shëndetësor

Shoqëria, në rrjedhën normale të veprimtarisë së saj, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit vendas. Kostot e bëra në emër të Shoqërisë i ngarkohen fitimit dhe humbjes kur ndodhin.

Përveç kësaj, Shoqëria ofron përfitimet të tjera për punonjësit si ulje çmimi për punonjësit dhe shpërblime të ndryshme të performancës. Këto kosto njihen në fitim dhe humbje kur ndodhin.

n. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare, por ato paraqiten në shënimet e pasqyrave financiare, për aq sa mundësia e një daljeje burimesh që përfshijnë përfitimet ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset për aq sa është e mundshme një hyrje e përfitimëve ekonomike. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se mund të bëhet një detyrim i lindur në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3.1 VLERËSIMET E RËNDËSISHME KONTABËL

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacioni për elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet shpjeguese të mëposhtme. Përdorimi i supozimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e natyrës së operacioneve që kryen Shoqëria.

3.1 VLERËSIMET E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

